



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
DREJTORIA E MBIKQYRJES SË TREGUT

Tiranë, më 27/03/2008

**NJOFTIM PARAPRAK PËR PËRJASHTIM NGA NDALIMI I
MARRËVESHJES**

“AMERICAN EXPRESS INDEPENDENT AGREEMENT”

Më datë 11.03.2008, Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 7 dhe nenin 49, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” ka marrë njoftimin nga Alpha Bank Shqipëri, për përjashtimin e Marrëveshjes “American Express, Independent Agreement” të lidhur më datë 14 Gusht 2007, midis American Express (AMEX) dhe Alpha Bank me objekt përdorimin ekskluziv me afat 6 vjet të licencës të produktit/shërbimit “Karta American ekspres”.

Veprintaria kryesore e Alpha Bank është të ushtrojë aktivitetet bankar si dhe të ofrojë produkte dhe shërbime financiare. Alpha Bank është një prej 16 Bankave të nivelit të dytë, që ushtrojnë veprintari bankare në Republikën e Shqipërisë, e cila është krijuar si Degë e Alpha Bank Greke. Alpha Bank – Albania, do të ofrojë shërbimin e lëshimit dhe përvetësimit të kartës American Express nëpërmjet rrjetit të degëve të saj në Shqipëri.

American Express Limited (“Amex”) me adrese 200 Vesey Street Neë York, USA, ushtron aktivitetin ekonomik për dhënie licence palëve të treta për të emetuar Karta American Express dhe kryerjen e blerjeve tregtare në lidhje me Kartat American Express jashtë Shteteve të Bashkuara.

Sipas kësaj marrëveshje American Express autorizon të licencuarin (Alpha Bank një bankë e themeluar në Greqi dhe që ka një rrjet degësh në Shqipëri) të drejtojë Shërbimin e Kartave të American Express në Shqipëri.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të ardhur, Autoriteti Konkurrencës konstatoi që, njoftimi i marrëveshjes për përjashtim është në përputhje me nenin 7, 48, dhe 49 të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”. Ky njoftim do ti nënshtrohet procedurës së përjashtimit të marrëveshjeve nga ndalimi të përcaktuar në Seksionin II të Ligjit “Për Procedurat për përjashtimin e marrëveshjeve nga ndalimi”.

Autoriteti i Konkurrencës fton palët e treta për të shprehur opinionet e tyre për marrëveshjen e njoftuar.

Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi në adresat: Autoriteti i Konkurrencës, me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr "Sami Frashëri", Nr 4 Tiranë; fax (nr 0355 4 234 497), e-mail në adresën competition@caa.gov.al.